



**Rishikimi i Agjencive të Pavarura me qëllim  
racionalizimin e funksioneve dhe ngritjen e  
performancës**



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

**MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK**

**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION

**Autor:** Jeton Oruçi

**Editor:** Burim Ejupi

---

"Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së."

## Përmbajtja e tabelës

I. HYRJE.....	3
II. Metodologjia.....	4
III. Rregullimi ligjor i Agjencive të Pavarura dhe aspektet Kushtetuese .....	6
IV. Faza I - Rishikimi i Agjencive/trupave .....	12
1. Akademia e Drejtësisë.....	12
2. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore.....	14
3. Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale .....	16
4. Agjencia për Ndihmë Juridike Falas .....	17
5. Agjencia për Krahasim dhe Verifikim të Pronës .....	19
6. Agjencia Kosovare e Privatizimit .....	21
7. Akademia e Arteve dhe Shkencave e Kosovës .....	23
V. Faza II - Grupimi i rregulltarovë sipas fushës nën një ombrellë .....	24
VI. Faza III - Ndryshimet Kushtetuese.....	25
VII. Rekomandimet e përgjithshme mbi ri-organizimin e Agjencive të Pavarura .....	26
7.1. Rekomandimi specifik 1 (Opsioni i preferuar).....	27
7.2. Rekomandimi specifik 2 (Opsioni i dytë) .....	27
7.3. Rekomandimi specifik 3 (Opsioni i tretë).....	28
VIII. Shtojca 1 (shembull i përmbajtjes së ligjit) .....	29
IX. Tabela me agjencitë/autoritet e propozuara për bartje. ....	33

## I. HYRJJE

Ky hulumtim vie si nevojë e domosdoshme pas realizimit të dy (2) punimeve të INDEP-it të cilat adresonin aspektet e funksionimit dhe llogaridhënies të Agjencive të Pavarura: *“Funksionalizimi i punës së Agjencive të Pavarura, sfidat dhe rruga përpara, e vitit 2016”* si dhe *“Balancimi mes Pavarësisë dhe Llogaridhënies: Praktikrat ekzistuese dhe rekomandime për mbikëqyrjen parlamentare të Agjencive të Pavarura , e vitit 2015”*, me qëllim konkretizimin e çështjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin e Agjencive të Pavarura.

Të dy (2) këto punime, kishin për qëllim ofrimin e alternativës për zgjidhjen e problemeve kryesore të funksionimit të Agjencive të Pavarura, si dhe kishin për synim të kontribuonin në debatin rreth arritjes së një bilanci në mes të pavarësisë dhe llogaridhënies të Agjencive të Pavarura, aq i nevojshëm dhe i domosdoshëm për funksionimin e shëndetshëm të sistemit politik dhe raportit ndër-institucional.

Ky dokument ka për qëllim t’u ofrojë deputetëve të Kuvendit të Kosovës zgjidhje konkrete se si do të mund të arrihej një rishikim i mirëfillt i funksioneve dhe Agjencive të Pavarura me qëllim që të sigurohet një racionalizim i Agjencive në kuadër të Kuvendit dhe të krijohen kushtet për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve në funksion të qytetarëve. Rjedhimisht, nga ky rishikim do të përfitoj në radhë të parë Kuvendi duke qenë më i strukturuar dhe do të ketë më të lehtë të kryej funksionet e tij në aspektin e monitorimit të punës së Qeverisë dhe institucioneve të cilat i raportojnë.

Si rezultat i strukturimit më të mirë të agjencive dhe funksioneve të tyre, mund të reduktohet: kostoja operationale, përdorimi më i mirë i burimeve njerëzore; përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe rritja e kënaqshmërisë e qytetarëve për shërbimet e marra.

Aspekti i nevojës së racionalizimit të Agjencive është kërkesë që del edhe nga Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën i vitit 2018 i cili përmend se *“politizimi i administratës publike mbetet sfidë dhe se gjithashtu mbikëqyrja e Qeverisë nga ana e Kuvendit mbetet e dobët”*. Si një nga shkaqet e mbikëqyrjes së dobët përmendet numri i madh i Agjencive respektivisht tridhjet e dy (32) Agjencive/trupave që i raportojnë drejtpërdrejtë Kuvendit. Në këtë kontekst, raporti rekomandon që *Qeveria dhe Kuvendi të zbatojnë rekomandimet për rishikimin e Agjencive dhe racionalizimin e tyre.*<sup>1</sup>

Gjithashtu, nga Raporti i SIGMA-së *(Iniciativës së përbashkët të shteteve anëtare të Organizatës për zhvillim dhe bashkëpunim Ekonomik (OECD) dhe Bashkimit Evropian (BE) për Mbështetje në përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit)* e cila bënë monitorimin e zbatimit të Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike, theksohet që *Kuvendi vazhdon të mbikëqyr një numër të autoriteteve publike, pa mjetet apo kapacitetet për t’i mbikëqyrur ato.*<sup>2</sup> Gjithashtu, kërkon nga Qeveria në bashkëpunim me Kuvendin përgatitjen e një programi të reformës së Agjencive duke përgatitur propozimet ligjore për Agjencitë përkatëse. Në këtë drejtim, kërkon nga Kuvendi, Qeveria dhe Ministritë të forcojnë kapacitetet në kontrollin

---

<sup>1</sup>Kosovo Report 2018, European Commission, Commission Staff Working Document, Strasbourg, 17.4.2018 SWD(2018) 156 final, faqe 10: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>

<sup>2</sup>SIGMA Monitoring Report: The Principles of Public Administration, Kosovo, November 2017 <http://sigmaweb.org/publications/public-governance-monitoring-reports.htm> ;

dhe mbikëqyrjen e Agjencive gjysëm të pavarura të cilat i japin llogari Kuvendit, Qeverisë dhe Ministrive.

Nevoja për racionalizimin e Agjencive është shprehur edhe në dokumentet si në vijim:

- Kontratën për përkrahje buxhetore sektoriale për Reformën e Administratës Publike dhe objektivat e ndërlidhuara për të cilat Qeveria është angazhuar përmes treguesve të Përkrahjes Buxhetore Sektoriale (PBS);<sup>3</sup>
- Agjendën Evropiane e Reformave kërkon bënë thirrje për racionalizimin e Agjencive;
- Strategjinë e Modernizimit të Administratës Publike të Qeverisë së Kosovës, dhe
- Koncept Dokumentin për administratën shtetërore i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Në këtë kontekst, ky punim trajton aspektet të cilat kanë të bëjnë me Agjencitë e Pavarura të Kuvendit me qëllim që të ofroj rekomandime se si kërkesat e lartcekura do të mund të adresoheshin dhe konkretizoheshin në praktikë.

Njëri ndër synimet e këtij punimi është ofrimi i të dhënave dhe krijimi i mundësisë për diskutime se si mund të realizohet rishikimi i Agjencitë e Pavarura në Kosovë dhe të bëhet bartja e disa nga Agjencive të Pavarura, nga legjislativi në ekzekutiv.

Aspektet e llogaridhënies, transparencës, pavarësisë buxhetore, emërimeve dhe strukturës që duhet të ketë Agjencia e Pavarur, nuk është objekt trajtimi i këtij punimi pasi që këto çështje është trajtuar në punimin tjetër të INDEP-it për Rregullimin ligjor të Agjencive të Pavarura.

## II. Metodologjia

Ky punim, përmban një analizë të problemeve kryesore për Agjencitë/autoritetet e Pavarura në kuadër të Kuvendit, duke vënë në theks po ashtu numrin e lartë të Agjencive/autoriteteve të Pavarura.

Në funksion të rishikimit janë analizuar kompetencat dhe përgjegjësitë e secilës agjenci duke identifikuar tiparet e funksioneve të tyre. Gjithashtu, janë shikuar praktikatat e disa vendeve të rajonit, për të bërë një krahasim dhe për të ofruar rekomandime të përgjithshme dhe specifike për të mundësuar racionalizimin e tyre.

Është rishikuar korniza ligjore në fuqi e cila përackton fushat dhe përgjegjësitë e ekzekutivit për të identifikuar nëse kompetencat dhe përgjegjësitë të cilat ofrohen nga Agjencitë e Pavarura me tipare të funksioneve të ekzekutivit, mund të barten në ekzekutiv.<sup>4</sup>

---

<sup>3</sup> Kjo kontratë dhe Marrëveshja Financiare e ndërlidhur kanë hyrë në fuqi më 15 dhjetor 2017. Kjo kontratë parasheh mbështetje financiare për Kosovën nëse kjo e fundit arrin t'i realizoj targetet e përcaktuara ku në kuadër të saj është edhe pakoja e 3 ligjeve (Ligji për Pagat, Ligji për Shërbimin Publik dhe Ligji për Administratë Shtetërore) e cila është në një formë parakusht për realizimin e reformës së administratës publike.

<sup>4</sup> Në mungesë të një Ligji për Qeverinë, është shikuar Rregullorja Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë së Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, si dhe korniza ligjore në fuqi që rregullon kompetencat e autoriteteve publike.

Punimi është konceptuar në at formë që përcakton tre faza për të realizuar në tërësi racionalizimin e Agjencive të Pavarura.

**Faza e parë (I)** ka të bëjë me Agjencitë të cilat janë identifikuar në këtë punim të cilat duhet të barten në ekzekutiv. Të shtatë (7) Agjencitë e identifikuar duhet të barten nga Kuvendi në Qeveri përkatësisht në Ministrinë përkatëse varësisht nga kompetencat dhe fushëveprimi i Agjencisë.

Shembulli mund të jetë që Agjencia për Ndihmë

Juridike Falas, të bartet nga Kuvendi në Qeveri respektivisht në Ministrinë përkatëse të Drejtësisë, apo në Këshillin Gjyqësor.<sup>5</sup>

**Faza e dytë (II)** ka të bëjë me identifikimin e rregullatorëve dhe zyreve rregullatore të cilët ofrojnë shërbime sipas fushave përkatëse. Rregullatorët të grupohen sipas fushës nën një ombrellë. Shembulli i Mbretërisë së Bashkuar mund të merret në konsideratë.


Shembulli i Mbretërisë së Bashkuar, në Kosovë do të mund të aplikohet në atë mënyrë që Rregullatorët e tregut të funksionojnë nën një ombrellë. Ashtu sikurse që rregullatorët dhe institucionet e Sigurisë do të mund të grupoheshin nën një ombrellë.

**Faza e tretë (III)** ka të bëjë me ndryshimet Kushtetuese.

Në momentin e inicimit të amendamentimit të Kushtetutës, qoftë edhe për arsye tjera, sikurse ndryshimet për aspektet e sigurisë apo sistemit zgjedhor apo edhe arsye tjera, në këtë proces të rishikohet në vecanti Kapitulli XII i Kushtetutës për të hequr nga Kushtetuta, Agjencitë (emërtimet e Agjencive) të cilat specifikohen në Kushtetutë pasi që një gjë e tillë nuk ka nevojë të përcaktohet në të. Në këtë Kapitull do të duhej të vendoseshin dispozita shumë precize për sigurimin e funksionimit të Agjencive të Pavarura duke përfshirë aspektet e pavarësisë buxhetore, të pavarësisë së llogaridhënies etj.

Produktet finale të realizimit të tre (3) fazave të përmendura në këtë punim do të ishin:

1. Inicimi i një (1) ligji i cili do të ndryshonte dhe plotësonte shtatë (7) ligjet për Agjencitë e identifikuar, të cilat duhet të barten nga Kuvendi në Ministrinë përkatëse.



<sup>5</sup> Sqarim: Shprehja Ministrinë përkatëse sikur në rastin e Ministrisë së Drejtësisë është përdorur pasi që në të ardhmën dhe gjatë rishikimit emri i Ministrisë mund pësojë ndryshime, prandaj është përmendur Ministria përkatëse e fushës së drejtësisë.

Në mungesë të Ligjit për Qeverinë, i cili do të duhej të përcaktonte fushëveprimin e saj në përputhje me Kushtetutën, strukturën, kompetencat dhe përgjegjësitë e saj, gjatë analizës janë shikuar fushat e përgjegjësisë të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive me qëllim që të ofrohen rekomandime se në cilin resor të ekzekutivit do duhej të bartej një agjenci.

2. Hartimi i një ligji të ri kornizë i cili do të përcaktonte se cilat janë kushtet, kriteret dhe procedura për krijimin e një agjencie të re të pavarur.<sup>6</sup> Në at ligj propozimi është që të vendosen dispozita të qarta për kushtet e krijimit, strukturën e agjencisë, mënyrën e përzgjedhjes së pozitave udhëheqëse dhe mandatin e tyre, pavarësinë financiare etj.
3. Amendamentet Kushtetuese të cilat kanë të bëjnë me heqjen taksative të emërtimeve të Agjencive/autoriteteve të pavarura nga Kushtetuta. Ky propozim rekomandon që në Kushtetutë të vendosen dispozitat e fushëveprimit të një fushe të caktuar pa specifikuar agjencinë/emërtimin e saj. Caktimi i Agjencisë apo bashkimi i Agjencive pastaj do të mund të bëhet me ligj. Në rastin e amendamenteve të Kushtetutës, neni 142 do të duhej të rishikohej në tërësi për të siguruar pavarësinë e plotë të tyre në kuptim të buxhetit, ndalimit të ndikimit në Agjenci nga ndërhyrjet politike si dhe aspektet që kanë të bëjnë me llogaridhënien.

Ndërsa për sa i përket efekteve nga rishikimi dhe racionalizimi i Agjencive, në një të ardhme, përkatësisht dy (2) vite pas bartjes së Agjencive në ekzekutiv, do duhej të bëhet një analizë ex-post (parapavepruese) për të matur ndikimet dhe efektet e rishikimit.

### **III. Rregullimi ligjor i Agjencive të Pavarura dhe aspektet Kushtetuese**

Institucionet e pavarura janë elementi kryesor i një demokracie funksionale. Bashkë me pushtetin legjislativ, atë ekzekutiv dhe gjyqësor mundësojnë një sistem të zhvilluar të ruajtjes së baraspeshës, duke shtuar përgjegjshmërinë dhe duke zbutur ndikimin jo të drejtë politik. Sfidat që e përcjellin demokracinë në tranzicion të Kosovës, megjithatë vazhdojnë të pengojnë zhvillimin e institucioneve duke u nisur që nga mungesat e vazhdueshme të resurseve e deri te ndërhyrjet politike.<sup>7</sup> Kjo dukuri bëhet e evidente në rastet, kur të drejtat, përgjegjësitë, pavarësia funksionale, financiare, e emërimit dhe vendimmarrjes nuk janë mirë të precizuara në ligjet përaktëse.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përkatësisht neni 4 përcakton formën e qeverisjes, ndarjen e pushteteve dhe kontrollin e balancimit në mes tyre. Në këtë kontekst, Kuvendi është autoriteti i cili ushtron pushtetin legjislativ (ligjbërës) dhe mbikëqyrës. Qeveria është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve, politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar. Për më tepër, neni 65

---

<sup>6</sup>Ky rekomandim elaborohet në punimin e dytë që ka të bëjë me Rregullimin ligjor të Agjencive të Pavarura.

<sup>7</sup>Gjendja e Institucioneve të Pavarura në Kosovë, OSBE, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, korrik 2012, faqe 4. <https://www.osce.org/sq/kosovo/92052?download=true>;

paragrafi 9 i Kushtetutës, e bënë Kuvendin përgjegjës për të mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve tjera publike, të cilat në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit.

Kjo nënkupton që Qeveria ushtron pushtetin ekzekutiv në funksion të zbatimit të ligjeve dhe akteve tjera të miratuara nga Kuvendi.

Për sa i përket funksionimit të Agjencive të Pavarura, neni 142 i Kushtetutës, përcakton që Agjencitë e Pavarura i themelon Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Për dallim nga Agjencitë ekzekutive në varësi të ekzekutivit, Agjencitë e Pavarura funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, neni 142 u garanton buxhetin i cili administrohet në mënyrë të pavarur. Por, çështja ka të bëjë me at se sa këto të drejta të garantuara me Kushtetutë aplikohen me të vërtetë përmes ligjeve të cilat janë miratuar nga Kuvendi?

Neni 142 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe Ligji Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore nuk ofrojnë qartësi të mjaftueshme si mbi çfarë kushte mund të krijohet një Agjenci e pavarur. Në këtë kontekst, gjithashtu SIGMA<sup>8</sup> në raportin monitorues për Kosovën *“Principet e Administratës Publike”* thekson që janë dy çështje kryesore për sa i përket rregullimit ligjor:

1. Rregullimi nuk është i qartë në themelimin e Agjencive të ndryshme dhe nuk ofron kornizë të qartë në definimin e detyrave specifike dhe në përcaktimin e parimeve të qeverisjes.
2. Shumë Agjenci nuk i nënshtrohen fare rregullimit, duke u themeluar në bazë të ligjeve specifike, rast pas rasti.<sup>9</sup>

Ky punim, synon të nxjerrë në pah çështjet të cilat paraqesin vështirësi në vënien në funksion të garancive kushtetuese dhe ofron rekomandime se si do të mund të sigurohej zbatimi i drejtë i dispozitave kushtetuese, duke propozuar që Agjencitë e Pavarura të cilat kryejnë funksione ekzekutive të barten nga Kuvendi në Qeveri. Kësisoj, Kuvendi do të ketë më të lehtë të ushtroj kompetencat e përcaktuara në nenin 65 të Kushtetutës për të *mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit.*

Si fazë e dytë ofron propozimet mbi rekomandimet specifike se si rregullatorët e ndryshëm do të mund të funksionin nën një ombrellë sikurse rregullatorët e tregut (*Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, Komisioni për Miniera dhe Minerale, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit të grupohen nën një ombrellë*).

Kushtetuta në Kapitullin e saj të XII i referohet institucioneve të pavarura duke i përmendur në mënyrë specifike Agjencitë e të cilat në zhargonin ditor quhen si Agjenci të kategorisë kushtetuese. Megjithatë, Kapitulli i XII-të i Kushtetutës lë hapësirë për Kuvendin, që përveç institucioneve të pavarura të listuara në Kapitullin XII, të themelohen Agjenci tjera me ligje të vecanta.

---

<sup>8</sup>Iniciativë e përbashkët e shteteve anëtare të Organizatës për zhvillim dhe bashkëpunim Ekonomik (OECD) dhe Bashkimit Evropian (BE)

<sup>9</sup>SIGMA Monitoring Report: The Principles of Public Administration, Kosovo, November 2017.



Agjencitë e Pavarura të cilat përcaktohen sipas Kapitullit XII të Kushtetutës, janë:<sup>10</sup>

1. Institucioni i Avokatit i Popullit;
2. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës;
3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
4. Banka Qendrore e Kosovës;
5. Komisioni i Pavarur i Medieve.

Duke u thirrur në nenin 142 të Kushtetutës, Kuvendi i Republikës së Kosovës ndër vite ka themeluar Agjenci të cilat duhet të jenë të pavarura, apartiake, kompetente dhe t'i japin llogari Kuvendit sikurse e përcakton vetë Kushtetuta. Duhet theksuar se neni 142 i ka dhënë kompetenca të mëdha Kuvendit për të themeluar Agjenci rregullatore dhe ekzekutive të cilat duhet t'i raportojnë Kuvendit. Deri më tani, konsiderohet se janë themeluar rreth 38 Agjenci/trupa të Pavarura të cilat janë themeluar me ligje të vecanta në pajtim me Kushtetutën. Bazuar në të dhënat e prezantuara në raportin e Ministrisë së Administratës Publike, numri i të punësuarve në Agjencitë e Pavarura të krijuara nga Kuvendi është rreth 4.634 të punësuar.<sup>11</sup>

Për sa i përket themelimit të Agjencive në kuadër të ekzekutivit, Qeveria mbi bazën e Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës ka themeluar 46 organe qendrore me ligje të vecanta në varësi të Qeverisë respektivisht ministrive përkatëse.<sup>12</sup>

Padyshim që numri kaq i lartë i Agjencive të Pavarura por edhe të atyre në kuadër të ekzekutivit e bënë më komplekse ndarjen e pushteteve e cila garantohet me Kushtetutë dhe njëkohësisht e vështirëson mbikëqyrjen dhe kontrollin parlamentar ndaj performancës së këtyre institucioneve në vecanti të institucioneve të pavarura.

Çështja bëhet edhe më komplekse pasi që Kushtetuta nuk ofron bazë të qartë ligjore se mbi çfarë kushte dhe kriterë mund të themelohet një Agjenci përkatësisht cilat janë kostot dhe përfitimet e ekzistencës së një organi të pavarur. Kjo çështje nuk është e mirëprecizuar as në Ligjin Nr. 03L-189 për Administratën Shtetërore. Përvoja e deritanishme, tregon që Agjencitë dhe autoritetet e caktuara të pavarura janë themeluar mbi bazën e ligjeve specifike të cilave ju ka munguar një analizë paraprake (ex-ante) se cilat janë përfitimet por edhe kostoja e krijimit të asaj Agjencie.

Duke u ballafaquar me këtë situatë të numrit të lartë të Agjencive të Pavarura, Kuvendi shpesh nuk ka fuqi dhe kapacitete të mbikëqyrë në mënyrë efektive aktivitetet e tyre. Linjat e llogaridhënies në kuadër të institucioneve janë të dobëta pasi që nuk janë të precizuara mirë në ligjet e vecanta mbi bazën e të cilit ligj funksionon Agjencia.

Në këtë kontekst, Kuvendi në bashkëpunim me Qeverinë duhet të intensifikojnë veprimet në drejtim të zbatimit të rishikimit të Agjencive të Pavarura për t'i bartur Agjencitë e caktuara në

---

<sup>10</sup>Kapitulli XII i Kushtetutës së Republikës së Kosovës: <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

<sup>11</sup>Funksionalizimi i punës së agjencive të pavarura, sfidat dhe rruga përpara (Dardan Abazi dhe Burim Ejupi, 2016) [http://indep.info/wp-content/uploads/publikimet\\_sq/Funksionalizimi%20i%20pun%C3%ABs%20s%C3%AB%20agjencive%20t%C3%AB%20pavarura%20sfidat%20dhe%20rruga%20p%C3%ABrpara%20%5BDardan%20Abazi%20Dhe%20Burim%20Ejupi%202016%2002%20Qeverisje%20Demokratike%5D.pdf](http://indep.info/wp-content/uploads/publikimet_sq/Funksionalizimi%20i%20pun%C3%ABs%20s%C3%AB%20agjencive%20t%C3%AB%20pavarura%20sfidat%20dhe%20rruga%20p%C3%ABrpara%20%5BDardan%20Abazi%20Dhe%20Burim%20Ejupi%202016%2002%20Qeverisje%20Demokratike%5D.pdf).

<sup>12</sup>Rishikimi i institucioneve dhe agjencive të pavarura të Kuvendit dhe organeve qendrore të Qeverisë, 2016 [https://map.rks-gov.net/Dokumentet/Rishikimi\\_i\\_institucioneve\\_dhe\\_agjencive\\_te\\_pavaru.aspx/](https://map.rks-gov.net/Dokumentet/Rishikimi_i_institucioneve_dhe_agjencive_te_pavaru.aspx/)

Qeveri të cilat ushtrojnë funksione ekzekutive. Duhet pranuar faktin se një administratë publike profesionale ndikon pozitivisht në zhvillimin dhe zbatimin e politikave në nivel më të lartë e që rrjedhimisht kjo ndikon pozitivisht në ofrimin e shërbimeve publike ndaj qytetarëve dhe bizneseve si dhe krijon mundësi për zhvillimin ekonomik në përgjithësi. Njëkohësisht, rrit besimin e qytetarëve ndaj Kuvendit dhe agjencive të pavarura.

Ky dokument, bënë identifikimin e Agjencive që për nga tipologjia e tyre mund të barten në kuadër të ekzekutivit pasi që merr në konsideratë fushëveprimin ligjor të Agjencisë. Mbi bazën e fushëveprimit të Agjencisë, ofron rekomandime konkrete se ku duhet të bartet Agjencia si hap i parë në procesin e racionalizimit të Agjencive.

#### **Agjencitë/trupat e pavarur dhe nevoja për racionalizimin e tyre në kuadër të Kuvendit**

	<b>Emri</b>	<b>Lloji</b>	<b>Bordi</b>	<b>Viti i themelimit</b>
1	<b>Institucioni i Avokatit të Popullit</b>	<b>Institucion Kushtetues</b>	/	2000
2	<b>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve</b>	<b>Agjenci Kushtetuese</b>	<b>Ekzekutiv</b>	2000
3	<b>Trusti Pensional i Kosovës</b>	<b>Agjenci</b>	<b>Ekzekutiv</b>	2001
4	<b>Agjencia Kosovare e Privatizimit</b>	<b>Agjenci Rregullatore</b>	<b>Ekzekutiv</b>	2002
5	<b>Bordi për Rishqyrtimin e Ankesave</b>	<b>Agjenci</b>	<b>Ekzekutiv</b>	2002
6	<b>Autoriteti për Komunikime Elektronike dhe Postare</b>	<b>Agjenci</b>	<b>Mbikëqyrës</b>	2003
7	<b>Komisioni Rregullativ i Prokurimit</b>	<b>Agjenci</b>	<b>Ekzekutiv</b>	2003
8	<b>Zyra e Rregullatorit për Energji</b>	<b>Rregullator</b>	<b>Ekzekutiv</b>	2004
9	<b>Komisioni i Pavarur për Medie</b>	<b>Kushtetuese</b>	<b>Ekzekutiv</b>	2005
10	<b>Komisioni për Miniera dhe Minerale</b>	<b>Rregullator</b>	<b>Ekzekutiv</b>	2005
11	<b>Këshilli Gjyqësor i Kosovës</b>	<b>Agjenci</b>	<b>Ekzekutiv</b>	2005
12	<b>Instituti Gjyqësor i Kosovës</b>	<b>Agjenci</b>	<b>Ekzekutiv</b>	2006
13	<b>Komisioni për Dhënjën e Provimit të Jurisprudencës</b>	<b>Agjenci</b>	<b>Ekzekutiv</b>	2006
14	<b>Bordi për Ankesa i Mediave</b>	<b>Agjenci</b>	<b>Ekzekutiv</b>	2007

15	Autoriteti për Mbrojtjen e Konkurrencës	Agjenci	Ekzekutiv	2007
16	Agjencia Kundër Korrupsionit	Agjenci		2007
17	Agjencia Kosovare e Pronës – Bordi Mbikëqyrës	Agjenci	Mbikëqyrës	2008
18	Agjencia Kosovare e Pronës – Sekretariati Ekzekutiv	Agjenci	Ekzekutiv	2008
19	Agjencia Kosovare e Pronës – Komisioni për Kërkesa Pronësore	Agjenci	Ekzekutiv	2008
20	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	Rregullator	Ekzekutiv	2008
21	Autoriteti i Aviacionit Civil	Rregullator	Mbikëqyrës	2008
22	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	Agjenci	Ekzekutiv	2008
23	Zyra e Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim	Rregullator	Ekzekutiv	2008
24	Komisioni Shqyrtues i Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim	Agjenci	Ekzekutiv	2008
25	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil	Agjenci	Ekzekutiv	2008
26	Bordi i RTK		Ekzekutiv	2008
27	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	Kushtetuese	Ekzekutiv	2008
28	Gjykata Kushtetuese e Kosovës	Kushtetuese	Ekzekutiv	2008
29	Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik	Agjenci	Ekzekutiv	2008
30	Bordi Këshilldhënës për Mbrojtjen e Mjedisit	Agjenci	Ekzekutiv	2009
31	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Agjenci	Mbikëqyrës	2010
32	Banka Qendrore e Kosovës	Kushtetuese	Ekzekutiv	2010
33	Komisioni Qendror për Regjistrimin e Popullsisë,	Agjenci	Mbikëqyrës	2010

	<b>Ekonomive Familjare dhe të Banesave</b>			
<b>34</b>	<b>Këshilli Prokurorial i Kosovës</b>	<b>Agjenci</b>	<b>Ekzekutiv</b>	<b>2010</b>
<b>35</b>	<b>Këshilli për Ndihmë Juridike Falas</b>	<b>Agjenci</b>	<b>Ekzekutiv</b>	<b>2012</b>
<b>36</b>	<b>Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale</b>	<b>Agjenci</b>	<b>Drejtor</b>	<b>2013</b>
<b>37</b>	<b>Këshilli Kombëtar i Shkencës</b>	<b>Agjenci</b>	<b>Ekzekutiv</b>	<b>2013</b>

**Tabela 1. Lista e Agjencive të Pavarura ekzistuese<sup>13</sup>**

Edhe pse nga të dhënat e prezantuara në tabelën 1, mund të shihet se numri më i madh i Agjencive të Pavarura të themeluara, ishte në periudhën kohore 2000 – 2007 ku gjithësej ishin themeluar 15 Agjenci, ky trend ka vazhduar me 13 Agjenci të themeluara në vitin 2008 dhe pastaj nëntë (9) Agjenci të themeluara nga viti 2008 deri më tani. Nga kjo mund të shihet se trendi i themelimit të Agjencive është në rënie e sipër, por megjithatë numri kaq i lartë i Agjencive dhe organeve të pavarura e vështirëson jashtzakonisht punën e Kuvendit që të ushtroj kompetencën e kontrollit parlamentar ndaj këtyre institucioneve por edhe ndaj ekzekutivit. Në total, deri më tani i bie se janë themeluar gjithsej përafërsisht 38 Agjenci të Pavarura.

Po ashtu nga Agjencitë e listuara më sipër, mund të vërehët se vendimmarrja e tyre është e përcaktuar në dy forma si organe kolegjiale apo individuale dhe kanë numër të ndryshëm të anëtarëve të bordeve ku mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të bordeve dallon nga Agjencia në Agjenci. Për sa i përket numrit të anëtarëve të bordeve, vlen të theksohet se nuk ka ndonjë rregull se cili është minimumi apo maksimumi, kjo çështje është theksuar edhe në rishikimin e Agjencive të Pavarura dhe atyre ekzekutive të përgatitur nga Ministria e Administratës Publike i cili thekson se *“ka agjenci me tre anëtar të bordit, për shembull: Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik dhe ka agjenci me 13 anëtar të bordit sikurse Instituti Gjyqësor i Kosovës ose Këshilli Gjyqësor i Kosovës”*<sup>14</sup>.

Duke u nisur nga fakti se disa nga Agjencitë dhe organet e listuara në tabelën 1, kryejnë funksione ekzekutive dhe ofrojnë shërbime të cilat bien në mandatin e sektorëve përkatës të ekzekutivit, fokusi do të jetë tek këto agjenci dhe organe që të identifikohet mandati i tyre si dhe të ofrohen të dhëna dhe informata për racionalizimin e Agjencive në kuadër të Kuvendit qoftë përmes bartjes së këtyre Agjencive në kuadër të ekzekutivit apo edhe duke propozuar shkrijen e funksioneve aktuale të agjencisë në kuadër të mekanizmave ekzistues, në kuadër të ministrisë, agjencisë, departamentit apo njesisë ekzistuese.

Agjencitë dhe organet në vijim do të analizohen secila ndaras për të ofruar rekomandime mbi nevojën e vazhdimin të ekzistencës në kuadër të Kuvendit apo bartjes së tyre në ekzekutiv:

<sup>13</sup> INDEP, Funkcionalizimi i punës së agjencive të pavarura, sfidat dhe rruga drejtë funksionalizimit, 2016.

<sup>14</sup> Rishikimi i Agjencive MAP, faqe 30: <https://map.rks-gov.net/getattachment/0d53302c-5f3f-4175-bec7-707d9692e3af/Rishikimi-i-Institucioneve-dhe-Agjencive-te-Pavaru.aspx>

1. Akademia e Drejtësisë;
2. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore;
3. Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale;
4. Agjencia për Ndihmë Juridike Falas;
5. Agjencia për Krahasim dhe Verifikim të Pronës;
6. Agjencia Kosovare e Privatizimit;
7. Akademia e Arteve dhe Shkencave e Kosovës.

#### **IV. Faza I - Rishikimi i Agjencive/trupave**

Në këtë pjesë të punimit, janë identifikuar Agjencitë dhe trupat që funksionojnë në kuadër të Kuvendit dhe fokusi do të jetë tek Agjencitë të cilat janë themeluar mbi bazën e ligjit specifik dhe nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e cila dispozitë siç e thamë më lartë është e përgjithshme.

Kjo fazë ofron të dhëna për fushëveprimin e secilës Agjenci veçmas dhe propozimin për bartjen e saj nga Kuvendi në Qeveri.

##### **1. Akademia e Drejtësisë**

Funksionon mbi bazën e Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, i cili rregullon statusin, funksionet dhe organet e Akademisë. Akademia kryen trajnime për gjyqtarë, prokurorë, personelin administrativ gjyqësor dhe prokurorial. Akademia është institucion i pavarur dhe organet e saj janë:

1. Këshilli Drejtues i cili udhëheq me Akademinë. Këshilli përbëhet nga nëntë (9) anëtarë dhe i njëjti i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës raport për punën e Akademisë së paku një (1) herë në vit.
2. Këshilli Programor është organ profesional i cili siguron cilësinë për trajnimet e ofruara dhe përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve. Për punën e vet Këshilli Programor i raporton Këshillit Drejtues, dhe
3. Drejtori Ekzekutiv i cili Zyrtar Kryesor Administrativ dhe është përgjegjës për menaxhimin, administrimin e përgjithshëm dhe ligjshmërinë e punës së Akademisë.

##### **Propozimi**

Nisur nga fakti që kjo Akademi ofron trajnime përkatësisht merret me ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve të gjyqësorit, por që nuk ka ndikim në emërimin, përzgjedhjen apo në ndikimin e drejtpërdrejtë e ushtrimit të profesionit të tyre, kjo Akademi do duhej të bartej në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Një mundësi tjetër, do të ishte bartja e kësaj Akademie në kuadër të Këshillit Gjyqësor apo Këshillit Prokurorial.

Prandaj, nisur nga fushëveprimi dhe mandati i kësaj Akademie, nuk ka asnjë arsye që e njëjta të jetë në kuadër të Kuvendit pasi që kësaj krijon pengesë për vetë Kuvendin që të ushtroj kontrollin efektiv ndaj Qeverisë dhe institucioneve tjera të cilat i raportojnë Kuvendit.

Për të bërë këto ndryshime, kërkohet të bëhen ndryshime ligjore.

##### **Akademia e Drejtësisë /Qendra e Trajnimit Gjyqësor, në vendet e rajonit**

## **Republika e Serbisë**

Qendra e trajnimit gjyqësor në Republikën e Serbisë ishte themeluar në vitin 2001 në bashkëpunim me Republikën e Serbisë e cila përfaqësohej nga Ministria e Drejtësisë dhe Shoqata e Gjyqtarëve të Serbisë. Qendra në parim kishte mandat avancimin profesional të gjyqtarëve, megjithatë kjo nuk ishte e detyrueshme, e gjithë nuk ishte e lidhur drejtpërdrejt me ndonjë avancim apo promovim në karrierë. Ligji i ri për Akademinë Gjyqësore në Republikën e Serbisë u miratua në dhjetor të vitit 2009, duke siguruar për herë të parë që trajnimi gjyqësor të integrohet në një proces gjithëpërfshirës të përzgjedhjes dhe rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Serbisë.<sup>15</sup> Miratimi i ligjit kishte shënuar një moment historik në procesin e reformës gjyqësore në Serbi, duke parashikuar kështu një sistem krejtësisht të ri të përzgjedhjes së rekrutimit dhe trajnimit fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të ardhshëm.<sup>16</sup>

Bazuar në Ligjin mbi themelimin e Akademisë Gjyqësore në Republikën e Serbisë, organet e saj janë Komiteti Drejtues, Drejtori dhe Këshilli Programor. Komiteti Drejtues përbëhet nga katër anëtarë të emëruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve, dy prej të cilëve emërohen me propozim të Asociacionit të Gjyqtarëve; dy anëtarë të emëruar nga Këshilli i Prokurorëve të Shtetit nga radhët e prokurorëve, një prej të cilëve emërohet me propozim të Asociacionit të Prokurorëve; dhe *tre anëtarë të emëruar nga Qeveria*, njëri prej të cilëve është sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë.<sup>17</sup>

## **Republika e Kroacisë**

Akademia Gjyqësore në Republikën e Kroacisë në vitin 2003, ishte quajtur “Qendra për Trajnimin Profesional të Gjyqtarëve” dhe nga të dhënat zyrtare figuron të ketë qenë njësi e pavarur brenda Drejtorisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Drejta të Njeriut nën ombrellën e Ministrisë së Drejtësisë, përderisa edhe pse në vitin 2004 themelohet Akademia Gjyqësore, fushëveprimi i saj ishte sërish nën ombrellën e Ministrisë së Drejtësisë.<sup>18</sup>

Që nga 1 janari i vitit 2010, Akademia Gjyqësore në Republikën e Kroacisë ka funksionuar si një institucion publik, i pavarur nga Qeveria, objektivat e të cilit përfshijnë përpjekjet për të krijuar kushte për zbatimin e programeve fillestare të trajnimit për pjesëmarrësit në organet gjyqësore dhe kandidatët për gjyqtarë dhe zëvendës prokurorë dhe për të siguruar trajnim të vazhdueshëm profesional për gjyqtarët dhe zëvendësprokurorët.<sup>19</sup>

Bazuar në legjilacionin në fuqi, organet e saj janë këshilli drejtues; këshilli i zhvillimit të programeve dhe Drejtori. Qeveria Kroate është pjesë e këshillit drejtues dhe përfaqësohet nga Ministri i Drejtësisë.

## **Republika e Sllovenisë**

---

<sup>15</sup> Ligji për Akademinë Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, Nr. 104/09, 32/14 - Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, dhe 106/15);

<sup>16</sup> Institucionet Gjyqësore në Serbi, hulumtim nga OSCE <https://www.osce.org/serbia/82759?download=true> ;

<sup>17</sup> Prezantim për Akademinë Gjyqësore, [http://www.mdtfjss.org.rs/archive/file/resources/Judicial\\_Academy.pdf](http://www.mdtfjss.org.rs/archive/file/resources/Judicial_Academy.pdf);

<sup>18</sup> Akademia Gjyqësore në Republikën e Kroacisë [http://rai-see.org/wp-content/uploads/2015/07/Judicial\\_Academy-Croatia.pdf](http://rai-see.org/wp-content/uploads/2015/07/Judicial_Academy-Croatia.pdf)

;

<sup>19</sup> Faqja zyrtare e Akademisë Gjyqësore në Republikën e Kroacisë, <http://www.ejtn.eu/About-us/Members/Croatia/> ;

Për dallim nga përvoja e dy shteteve të lartcekura, Republika e Sllovenisë kishte themeluar Qendrën e Trajnimit Gjyqësor më 1 qershor të vitit 2006 në pajtim me nenin 74 të Aktit të Gjykatave si një organ nën ombrellën e Ministrisë së Drejtësisë.<sup>20</sup> Në mandat të saj, Qendra e Trajnimit Gjyqësor kryen të gjitha trajnimet gjyqësore dhe jo vetëm, por gjithashtu dhe organizimin e trajnimeve profesionale për prokurorët dhe avokatët e shtetit.

Qendra e Trajnimit Gjyqësor sipas legjislacionit përkatë menaxhohet nga një drejtor i cili është një gjyqtar i caktuar po nga vet Qendra në një mandat prej tri viteve në pajtim me nenet 71 dhe 71 (c) të Aktit të Shërbimit Gjyqësor. Vendimi për caktimin e një gjyqtari bëhet nga Këshilli Gjyqësor pas propozimit nga Ministri i Drejtësisë.<sup>21</sup>

<b>Akademia e Drejtësisë</b>	<b>Akti I Themelimit</b>	<b>Viti I themelimit</b>	<b>Mbikqyrja / raportimi</b>	<b>Bordi dhe emërimi i tij</b>
<b>Republika e Serbisë</b>	Është themeluar me Ligjin për Akademinë Gjyqësore. <sup>22</sup>	2001 2009	Këshilli i Lartë Gjyqësor; Qeveria përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë;	Komiteti Drejtues, Drejtori dhe Këshilli Programor / anëtarët e Qeverisë përkatësisht MD marrin pjesë Komitetin drejtues
<b>Republika e Kroacisë</b>	Akti i Akademisë së Drejtësisë më 1 janar 2010	2003 2004 2010	Në Këshillin Drejtues është pjesëmarrëse edhe Qeveria e cila përfaqësohet nga Ministri i Drejtësisë	Gjyqtarë të Gjykatës Supreme / njëri nga ta është dhe Presidenti i Këshillit të zhvillimit të Programit; Prokuror të Përgjithshëm të Shtetit; Gjyqtar i Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje; Gjyqtar i Gjykatës së Lartë për Kundërvajtjes; etj
<b>Republika e Sllovenisë</b>	Aktit të Shërbimit Gjyqësor	2006	Qeveria përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë	Këshilli Gjyqësor pas propozimit nga Ministri i Drejtësisë.

## 2. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore

<sup>20</sup>Qendra e Trajnimit Gjyqësor në Republikën e Sllovenisë [http://www.ejtn.eu/Documents/About%20EJTN/Partner%20pages/JTC\\_brochure%202014\\_EJTN.pdf](http://www.ejtn.eu/Documents/About%20EJTN/Partner%20pages/JTC_brochure%202014_EJTN.pdf)

<sup>21</sup> Ministria e Drejtësisë, Republika e Sllovenisë [http://www.mp.gov.si/en/judicial\\_training\\_centre/](http://www.mp.gov.si/en/judicial_training_centre/)

<sup>22</sup> "Gazeta zyrtare e RS", No 73/10 of 12 Tetor 2010'

Funksionon mbi bazën e Ligjit Nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore, i cili rregullon fushën e trashëgimisë kulturore në lidhje me ruajtjen, mbrojtjen, qasjen publike, komunikimin dhe pajisjen e burimeve të domosdoshme. Gjithashtu, ky ligj vendos marrëdhëniet midis pronarëve, posduesve dhe shfrytëzuesve të trashëgimisë kulturore, qofshin ata individë ose komunitete ose autoritete publike përgjegjëse për vlerësimin e trashëgimisë kulturore.

Këshilli është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi sipas ligjit të lartcekur. Struktura organizative e KKTK përbëhet nga Bordi dhe Sekretariati. Në këtë drejtim, bordi përbëhet nga 7 të cilët zgjidhen për një mandat 3 vjeçar nga Kuvendi i Kosovës. Neni 4 paragrafi 4.8 përcakton që “mënyra e organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Kosovës për trashëgimi kulturore rregullohet me një akt të brendshëm të miratuar prej Këshillit. Sekretariati udhëhiqet nga udhëheqësi i Sekretariatit i cili emëroet dhe shkarkohet nga Bordi dhe ka gjithashtu mandat 3 vjeçar.

### Propozimi

Në kuptim të fushëveprimit të Këshillit, vlenë të theksohet se fuhsat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive janë të definuara në Rregulloren Nr. 02/2011 e ndryshuar dhe plotësuar me 4 herë deri më tani.

Rregullorja Nr. 02/2012 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive përkatësisht shtojca 7 përcakton kompetencat e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ku ndër kompetencat tjera, ka edhe “*krijimin e politikës kulturore dhe planet e veprimit dhe zbaton legjislacionin për të përkrahur sektorin e kulturës, duke përfshirë programet për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore [...]”.*

Për për më tepër, në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve funksionon Departamenti i Trashëgimisë Kulturore i cili ka kompetenca të ngjashme me at të Këshillit.<sup>23</sup> Në këtë kontekst, propozimi është që Këshilli për Trashëgiminë Kulturore të bartet në kuadër të ekzekutivit përkatësisht në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe gjithashtu të bëhet shkrija e Këshillit dhe Departamentit në 1 trupë/organ brenda ministrisë.

Për të bërë këto ndryshime, kërkohet të bëhen ndryshime ligjore.

## **Këshilli për Trashëgimi Kulturore / Qendra për Trashëgiminë Kulturore, në vendet e rajonit**

### **Republika e Serbisë**

Qendra për Trashëgiminë Kulturore Jomateriale në Republikën e Serbisë u përrua në qershor të vitit 2012. Qëllimi i Qendrës është arritja më e mirë e statusit dhe përfshirja e trashëgimisë kulturore jomateriale si një burim i rëndësishëm brenda në fushën e zhvillimit social dhe ekonomik. Gjithashtu nën mandat të saj ka bashkëpunimin me institucionet e tjera përkatëse me qëllim të zbatimit të Konventës së UNESCO mbi Trashëgiminë Kulturore pas miratimit nga Kuvendi i Republikës së Serbisë i cili ratifikoi Konventën në fjalë në maj të vitit 2010.<sup>24</sup>

<sup>23</sup>Neni 9 i Rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të MKRS-së: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8278>.

<sup>24</sup>Faqja zyrtare e Ministrisë së Kulturës, Qendra për Trashëgiminë Kulturore Jomateriale, Republika e Serbisë <http://www.nkns.rs/en>



### Republika e Kroacisë

Konsideruar si njëra ndër shtetet Evropiane me numër më të lartë të trashëgimis kulturore në Bashkimin Evropian, Republika e Kroacisë menaxhon përgjegjësit dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nga Ministria e Kulturës, përkatësisht përmes Drejtorisë për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.<sup>25</sup>

### Republika e Sllovenisë

Instituti për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në Republikën e Sllovenisë u themelua në vitin 1999, sipas Ligjit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në Republikën e Sllovenisë.<sup>26</sup>

Ekspertët e Institutit të lartcekur për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe zyrat përkatëse rajonale janë përgjegjëse për ofrimin e rekomandimeve dhe të dhënave në Qendrën për Informim dhe Dokumentim të Trashëgimisë pranë Ministrisë së Kulturës së Republikës së Sllovenisë, e cila mban regjistrin elektronik të Trashëgimisë Kulturore të Paluajtshme. Regjistri në fjalë është një bazë zyrtare kompjuterike e cila përmbanë të dhënat e trashëgimisë kulturore të paluajtshme në Slloveni dhe është nën përgjegjësinë e Qeverisë së Republikës së Sllovenisë. Të gjitha njësitë e trashëgimisë kulturore të paluajtshme futen në regjister pavarësisht nga lloji, madhësia, pronësia edhe nëse janë/ apo nuk janë të mbrojtura ligjërish.

<u>Këshilli për Trashëgimi Kulturore</u>	<u>Akti Themelimit</u>	<u>Viti themelimit</u>	<u>Mbikqyrja / raportimi</u>	<u>Bordi dhe emërimi i tij</u>
<u>Republika e Serbisë</u>	/	2012	Ministria e Kulturës	/
<u>Republika e Kroacisë</u>	/	/	Ministria e Kulturës	/
<u>Republika e Sllovenisë</u>	Ligjit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në Republikën e Sllovenisë	1999	Ministria e Kulturës përkatësisht Qendra për Informim dhe Dokumentim të Trashëgimisë në Ministrinë e Kulturës.	/

### **3. Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale**

Funksionon mbi bazën e Ligjit Nr. 04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës i cili përcakton statusin, organizimin, funksionimin, detyrat, përgjegjësitë

<sup>25</sup>Faqja zyrtare e Ministrisë së Kulturës, Republika e Kroacië <http://www.min-kulture.hr/default.aspx?id=18877>

<sup>26</sup>Faqja zyrtare e Institutit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në Republikën e Sllovenisë, [https://www.culture.si/en/Institute\\_for\\_the\\_Protection\\_of\\_Cultural\\_Heritage\\_of\\_Slovenia](https://www.culture.si/en/Institute_for_the_Protection_of_Cultural_Heritage_of_Slovenia)

dhe financimin e Agjencisë. Agjencia ka kompetencën e menaxhimit të komplekseve memoriale të shpallura me vendim të Kuvendit me interes të vecantë kombëtare dhe me karakter historik.

Agjencia udhëhiqet nga Drejtori i cili është përgjegjës për administrimin, funksionimin dhe menaxhimin e Agjencisë. Drejtori zgjidhet nga Kuvendi dhe ka mandat 5 vjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje. Agjencia është person juridik e cila i raporton Kuvendit.

#### Propozimi

Në këtë kontekst, duhet pasur në konsideratë se në kuadër të ekzekutivit ekziston një resor i tërë sikurse Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e cila ka të përcaktuar fushëveprimin e saj në shtojcën 13 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushën e përgjegjësisë së Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive. Nisur nga fushat e përgjegjësisë së Ministrisë të përcaktuara në shtojcën 13 të kësaj rregullore, kjo agjenci do duhej të bartej në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Për më tepër, e njëjta do mund të rishikohej që nga niveli i Agjencisë të shëndërrohet në Departament në kuadër të MMPH. Opsioni tjetër i bartjes së kësaj Agjencie do të ishte në Ministrinë e Kulturës, e Rinisë dhe Sporteve.

Për të bërë këto ndryshime, kërkohet të bëhen ndryshime ligjore.

#### **4. Agjencia për Ndihmë Juridike Falas**

Funksionon në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas si institucion i pavarur e cila i përgjigjet Këshillit për Ndihmë Juridike Falas dhe Kuvendit. Me agjencinë udhëheq drejtori ekzekutiv i cili zgjidhet nga Këshilli për Ndihmë Juridike Falas. Këshilli është institucion themelor i cili përbëhet nga 7 anëtarë profesionistë të kualifikuar të fushës së drejtësisë. Anëtarët zgjidhen nga Kuvendi nga institucionet si në vijim: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria për Kthim dhe Komunitete, Ministria e Financave, Oda e Avokatëve të Kosovës, Gjykata Supreme dhe 1 përfaqësues të OJQ-ve sipas procedurës së përzgjedhjes të përcaktuar në ligj.

Me ligj përcaktohet se ofrimi i ndihmës juridike falas në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse, me anë të të cilit sigurohet qasje efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.

## Propozimi

Në kuptim të rishikimit të fushëveprimtarisë së kësaj Agjencie, mund të konkludohet se kjo Agjenci ofron shërbime të cilat kanë tipare të shërbimeve të cilat i ofron ekzekutivi përkatësisht Ministria e Drejtësisë.<sup>27</sup>

Ministria e Drejtësisë ndër të tjera, ka në kompetencë zhvillimin dhe zbatimin e politikave për të siguruar qasje të drejtë dhe efektive në sistemin e drejtësisë. Në këtë kontekst, kjo Agjenci do duhej të bartej në Ministrinë e Drejtësisë kështu duke i mundësuar Kuvendit që të jetë më e përqëndruar në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara me Kushtetutë, ligje specifike dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Për të bërë këto ndryshime, kërkohet të bëhen ndryshime ligjore.

## **Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, në vendet e rajonit**

### **Republika e Serbisë**

Qeveria e Republikës së Serbisë më 2010, kishte miratuar Strategjinë për “Ndihmë Ligjore Falas (Gazeta Zyrtare e RS Nr. 74/2010)” Materiali i ndihmës juridike falas rregullohet me Ligjin për Procedurën Civile të Republikës së Serbisë. Gjithashtu, ekziston një Ligj i veçantë për Ndihmën Ligjore Falas, i cila pritet të miratohet dhe parashihet të rregullojë fushën e ndihmës juridike falas në një mënyrë gjithëpërfshirëse.<sup>28</sup> Përderisa deri më tani, Ligji në fjalë nuk është miratuar ende, nga publikimi i draft ligjit vërehet që përmes tij parashihet themelimi i një komisioni për shqyrtimin e kërkesave për ndihmë ligjore falas, i cili do emërohej nga Ministria e Drejtësisë dhe do të funksiononte nën ombrellën e saj.

### **Republika e Kroacisë**

Republika e Kroacisë kishte miratuar Ligjin për ndihmë Ligjore falas në vitin 2008, i cili hyri në fuqi më 2009.<sup>29</sup> Ky ligj kishte themeluar Departamentin për Ndihmë ligjore falas, nën ombrellën e Ministrisë së Drejtësisë i cili dhe kishte përgjegjësi të shqyrtonte kërkesat të cilat pranoheshin pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara me Ligjin e lartcekur.

### **Republika e Sllovenisë**

Në Republikën e Sllovenisë, Aktin (ligjin) për Ndihmë Ligjore Falas ishte miratuar në vitin 2008 dhe plotësuar / ndryshuar në vitin 2015. Përderisa për të pasur të drejtën e aplikimit për ndihmë ligjore falas, përcaktohen kushte specifike që duhet plotësuar, ky mandat me ligjin e lartcekur ishte vendosur nën Ministrinë e Drejtësisë së Republikës së Sllovenisë.<sup>30</sup>

---

<sup>27</sup> Ligji Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2803>

<sup>28</sup> Ministria e Drejtësisë dhe administratës shtetërore, <http://arhiva.mpravde.gov.rs/lt/articles/pravosudje/atlas-pravosudja-republike-srbije/besplatna-pravna-pomoc.html>

<sup>29</sup> Hulumtim mbi zbatimin e Ligjit për ndihmë ligjore falas, <http://www.cpsisak.hr/wp-content/uploads/2015/12/Report-on-the-Implementation-of-the-Law-on-Free-Legal-Aid.pdf>

<sup>30</sup> Hulumtim mbi praktikat pa pagesë dhe Mundësitë në Slloveni

<https://www.lv.com/admin/Upload/Documents/Global%20Pro%20Bono%20Survey/pro-bono-in-slovenia.pdf>

<u>Agjencia për Ndhimë Juridike falas</u>	<u>Akti Themelimit</u>	<u>Viti themelimit</u>	<u>Mbikqyrja / raportimi</u>	<u>Bordi dhe emërimi i tij</u>
<u>Republika e Serbisë</u>	Nuk ka.	/	/	/
<u>Republika e Kroacisë</u>	Është Departament për ndihmë ligjore falas në Ministrinë e Drejtësisë	2008	Ministria e Drejtësisë	/
<u>Republika e Sllovenisë</u>	Është Komisioni nën ombrellën e Ministrisë së Drejtësisë	2008 Plotesuar me 2015	Ministria e Drejtësisë	/

## 5. Agjencia për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

Funksionon mbi bazën e Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Agjencia është institucion i pavarur dhe **ka mandat të përkohshëm** që ka të bëjë me zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe pronën private komerciale si dhe krahasimn e zgjidhjen e dallimeve në mes të dokumenteve kadastrale origjinale të marra në Kosovë nga autoritetet serbe para qershorit të vitit 1999 dhe të dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës, për pronën private, pronën private komerciale dhe pronën private të bashkësive fetare.<sup>31</sup>

Agjencia përbëhet nga:

1. Bordi Mbikëqyrës i Agjencisë;
2. Sekretaria Ekzekutive;
3. Komisioni për Kërkesa Pronësore (KKP);
4. Komisioni për Verifikim dhe Vendosje për Prona (KVVP).

1. Bordi mbikëqyrë punën administrative të agjencisë dhe ofron udhëzime për politikak dhe orientimin e përgjithshëm të Agjencisë.

Bordi përbëhet nga 5 anëtarë ku 2 anëtarë emërohen nga Kuvendi sipas propozimit të Kryeministrit. Ndërsa 3 anëtarë, emërohen nga Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (PSBE). Kryesuesi i Bordit zgjidhet nga Bordi Mbikëqyrës. Mandati i anëtarëve është 3 vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes.

2. Sekretaria Ekzekutive ka përgjegjësi mbledhjen dhe regjistrimn e rasteve bazuar në versionin origjinal të skanuar të dokumenteve kadastrale të para Qershorit të vitit 1999 të cilat janë marrë në

<sup>31</sup>Shih Ligjin Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13023>

Kosovë nga autoritetet serbe e të pranuar nga/përmes Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian, krahasimi i tyre me dokumentet kadastrale në Kosovë për të identifikuar dallimet apo mospërputhjet në mes të këtyre dy grupeve të dokumenteve sikurse përcaktohet në nenin 7 të ligjit.

Sekretaria ka Drejtorin dhe Zëvendësdrejtorin. Drejtori dhe Zëvendësdrejtori emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri me mandat 5 vjeçar, pa të drejtë rizgjedhje.

***Detyrat, përgjegjësitë dhe organizimi i Sekretarisë rregullohen me akt nënligjor të Qeverisë.***

Procedurat e brendshme mund të përcaktohen nga drejtori ekzekutiv sipas propozimit nga Sekretaria dhe në konsultim me Bordin.

3. Komisioni për Kërkesa Pronësore (KKP) merret me kërkesat e paraqitura në Agjencinë Kosovare për Prona deri në vendosjen e të gjitha kërkesave të pranuar.

Komisioni përbëhet nga 3 anëtarë.

Një (1) anëtarë do të emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës pas propozimit nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës. Mandati aktual i dy (2) anëtarëve ndërkombëtar të KKP-së, të cilët janë emëruar në pajtim me Ligjin 04/L-274 do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim. Mandati i anëtarëve është 3 vjeçar me mundësi riemërimi.

4. Komisioni për Verifikim dhe Vendosje për Prona (KVVP) bazuar në dokumentet dhe rastin të cilin Sekretaria ia dorëzon KVVP-së për vendimmarje, e cila shqyrton tërë dosjen e rastit dhe merr vendim sikurse përcaktohet në ligj.

KVVP përbëhet nga pesë (5) anëtarë. Dy (2) nga anëtarët e KVVP emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës pas propozimit nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ndërsa tre (3) nga pesë (5) anëtarët e Komisionit, duke përfshirë një (1) përfaqësues të komuniteteve jo shumicë, emërohen nga PSBE. Kryesuesi i KVVP zgjedhet nga anëtarët e KVVP.

#### Propozimi

Nisur nga mandati i kësaj agjencie e cila ka funksione ekzekutive ku mandati i saj është i përkohshëm dhe ka të bëjë me *“zgjdhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe pronën private komerciale si dhe krabasimn e zgjdhjen e dallimeve në mes të dokumenteve kadastrale origjinale të marra në Kosovë nga autoritetet serbe para qershorit të vitit 1999 dhe të dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës, për pronën private, pronën private komerciale dhe pronën private të bashkësive fetare”*, në këtë drejtim duhet theksuar se kjo agjenci do duhej të bartej në kuadër të ekzekutivit përkatësisht Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e cila ndër të tjera ka kompetencë të administroj dhe mirëmbaj sistemin kadastral dhe të standardeve.

Për të bërë këto ndryshime, kërkohet të bëhen ndryshime ligjore.

## 6. Agjencia Kosovare e Privatizimit

Funksionon mbi bazën e Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115, Ligjin Nr. 05/L-080 dhe Ligjin Nr. 06/L-023.

Agjencia ka kompetenca ekskluzive për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur, tranferuar ose shitur pronën, si dhe që të administrojë ndërmarrje në pronësi shoqërore sikurse përcaktohet në ligj. Agjencia përbëhet nga Bordi i Drejtorëve, Drejtori Menaxhues dhe dy zëvendës drejtor menaxhues, Drejtori e Sekretarisë Ekzekutive dhe stafi tjetër përkatës.

Ligji Nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115 dhe me Ligjin Nr. 05/L-080 përcakton përbërjen e Bordit.

Bordi përbëhet nga tetë (8) Drejtorë. Kuvendi i Kosovës, me propozim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, emëron Drejtorët e Bordeve. Kuvendi i Kosovës, me propozim të Qeverisë, nga radhët e anëtarëve të Bordit cakton Kryesuesin e Bordit. Bordi gjithashtu emëron zëvendës kryesues të Bordit, njërin prej anëtarëve të tij. Bordi emëron dhe shkarkon Drejtorin Menaxhues, dy (2) zëvendës drejtorët menaxhues dhe Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive të Bordit.

Kryesuesi, zëvendëskryesuesi dhe drejtorët tjerë të Bordit emërohen me mandat katër (4) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat. Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, emërohet me mandat katër (4) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Vlenë të theksohet se procesi i privatizimit konsideroht si proces i cili ka jetëgjatësi të caktuar. Thënë ndryshe, që nga themelimi i Agjencisë, kanë kaluar përafërsisht 15 vite dhe ende kjo Agjenci nuk ka përfunduar çështjet që kanë të bëjnë me privatizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore.

### Propozimi

Shërbimet që ofron kjo agjenci përkojnë me ofrimin e shërbimeve ekzekutive prandaj e njëjta propozohet të bartet në kuadër të ekzekutivit.

Gjithashtu këtu duhet pasur parasysh Ligjin Nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës të vitit 2017, i cili ligj ka për qëllim nxitjen, tërheqjen dhe krijimin e kushteve për realizimin e investimeve strategjike në Republikën e Kosovës. Sponsorizues i këtij Ligji ishte Ministria e Tregtisë dhe Industrisë pasi që bie në fushëveprimin e kësaj ministrie.

Në këtë kontekst, duke u nisuar nga qëllimi i vetë privatizimit i cili synon rritjen e investimeve dhe krijimin e mundësive për rritjen e investimeve në tokën e punëshme për të rritur kështu edhe prodhimtarinë bujqësore, AKP do të duhej të bartej në kuadër të ekzekutivit.

Brenda ekzekutivit, kjo agjenci vendin do të mund ta ketë në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik apo edhe në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për shkaqe të Ligjit për Investimet Strategjike dhe Ligjit për Investimet e Huaja.

Për më tepër, ka hapësirë të bëhet një analizë e detajuar për kohëzgjatjen e funksionimit të kësaj agjencia dhe nëse duhet të funksionoj në formë të Agjencisë apo të jetë departament në kuadër të MTI-së.

## **Agjencia e Privatizimit, në vendet e rajonit**

### **Republika e Serbisë**

Në Republikën e Serbisë, Agjencia e Privatizimit ishte themeluar me Ligjin për Privatizim në vitin 2014.<sup>32</sup>

Kjo Agjenci ishte shuar dy (2) vite pas përkatësisht në shkurt të vitit 2016, kështu përgjegjësit dhe kompetencat e plota mbi privatizimin kishin kaluar në Ministrinë e Ekonomisë. Sipas hulumtimeve, nga zyrtarët e qeverisë së Republikës së Serbisë ishte shpjeguar që Agjencia e Privatizimit ka pushuar së ekzistuari për shkak të racionalizimit të administratës qeveritare dhe konsolidimit fiskal.<sup>33</sup>

### **Republika e Kroacisë**

Fondi Kroat i Privatizimit është themeluar me ligj dhe ka statusin e një person juridik me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara me Aktin e Privatizimi Kroat apo Aktin e Fondit Kroat të Privatizimit.

Me qëllim të zbatimit dhe përfundimit të privatizimit të aseteve të transferuara përkohësisht nën menaxhimin e këtij Fondi të cilat pas privatizimit do të kalonin nën Departamentin për Zhvillim Ekonomik në Qeverinë Kroate, të gjitha kompetencat dhe përgjegjësit ishin përcaktuar në Kartën mbi funksionimin e Fondit.

Fondi përbëhet nga Bordi Mbikëqyrës të cilët i raportojnë Kuvendit Kroat dhe pjesë e bordit janë gjithsej tetë (8) deputet të emruar nga Kryetari i Kuvendit. Përderisa Bordi Drejtues i cili ka nën përgjegjësi përcaktimin e politikave operacionale, merrjen e vendime për shitjen e aksioneve, interesave të biznesit etj ka pesë (5) anëtar të emëruar nga Qeveria e Republikës së Kroacisë.<sup>34</sup> Dhe Presidenti i cili ka në përgjegjësi menaxhimin, përfaqësimin në emër të këtij Fondi së bashku me zavendësin e tij, emërohen nga Qeveria e Republikës së Kroacisë.

### **Republika e Sllovenisë**

Lidhur me çështjen e Privatizimit në Republikën e Sllovenisë, nga Raportet e publikuara të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) ishte potencuar që modeli i Sllovenisë për *rritje* të ekonomisë kishte pësuar rënie për shkak të qeverisjes së korporatave dhe përfshirës së tepërt të Qeverisë Sllovene. Përkundër disa përpjekjeve të privatizimit, përqindja e pronësisë shtetërore të Sllovenisë në ekonomi mbetet një nga më të lartat përfshirë të gjitha shtetet anëtare të OECD.<sup>35</sup>

---

<sup>32</sup> Ligji për Privatizimin, Republika e Serbisë [http://www.priv.rs/upload/document/law\\_on\\_privatization.pdf](http://www.priv.rs/upload/document/law_on_privatization.pdf)

<sup>33</sup> Asociacioni ligjor SOG, Privatizimi në Serbi <http://www.sog.rs/serbian-privatization-agency-ceased-to-exist-as-of-1-february-2016/>

<sup>34</sup> Analizë mbi Fondin Kroat të Privatizimit nga Boris Crnković, Željko Požega, Ivo Mijoč <ftp://ftp.repec.org/opt/ReDIF/RePEc/osi/journal/PDF/InterdisciplinaryManagementResearchVI/IMR6a44.pdf>

<sup>35</sup> Raport nga OECD mbi ndikimin e korporatave në ekonominë e Sllovenisë <https://www.oecd.org/corporate/slovenia-ensuring-effective-management-and-privatization-of-state-owned-enterprises.pdf>

Sidoqoftë, lidhur me çështjen e Privatizimit, Republika e Sllovenisë kishte marrë Vendime dhe kishte aprovuar Bordin Menaxhues/Drejtues me qëllim të përfilljes së procedurave të menaxhimit të privatizimit cilat kontrollohen nga vet ajo.<sup>36</sup>

<u>Agjencia e Privatizimit</u>	<u>Akti Themelimit</u>	<u>Viti themelimit</u>	<u>Mbikqyrja / raportimi</u>	<u>Bordi dhe emërimi i tij</u>
<b>Republika e Serbisë</b>	Është themeluar me Ligjin për Privatizim; Amandamenti i Ligjit për Privatizim	2014  Shuhet sipas amandamentit të Ligjit për Privatizim më 2016	Ministria e Ekonomisë	/
<b>Republika e Kroacisë</b>	Akti i transformim; Akti i Privatizimit; Korniza Ligjore e Privatizimit në Kroaci (procedurat ligjore).	1991 1993 2010	Kuvendit të Republikës së Kroacisë	Bordi Mbikëqyrës tetë (8) deputet të emruar nga Kryetari i Kuvendit; Bordi Drejtues pesë (5) anëtar të emëruar nga Qeveria e Republikës së Kroacisë. Presidenti dhe zëvendës Presidenti emërohen nga Qeveria e Republikës së Kroacisë.
<b>Republika e Sllovenisë</b>	Proedura përcaktuar nga Qeveria e Republikës së Sllovenisë	/	Qeveria	Qeverisë

## 7. Akademia e Arteve dhe Shkencave e Kosovës

Funksionon mbi bazën e Ligjit Nr. 05/L-038 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Akademia është institucioni më i lartë i shkencës dhe i artit i themeluar nga Kuvendi i Kosovës. Akademia është përgjegjëse të bëjë planifikimin e punës kërkimore-shkencore dhe artistike; pranimin e anëtarëve të rinj në përputhje me standardet e veprimtarisë shkencore dhe të krijimtarisë artistike; bashkëpunimin me institucionet, akademitë dhe organizatë ndërkombëtare në fushën e shkencës dhe artit etj. Gjithashtu kjo Akademi ka për qëllim realizimin e projekteve shkencore me interes për zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor.<sup>37</sup>

Organet e Akademisë janë: Kuvendi; Kryesia dhe Kryetari.

Kuvendi është organi më i lartë vendimmarrës i Akademisë i cili përbëhet nga të gjithë anëtarët e rregullt dhe anëtarët korrespondentë të Akademisë. Kuvendi miraton raportin e punës së

<sup>36</sup>Faqja zyrtare e Qeverisë së Sllovenisë [http://www.vlada.si/en/media\\_room/government\\_press\\_releases/press\\_release/article/slovenian\\_government\\_restarts\\_privatization\\_process\\_48146/](http://www.vlada.si/en/media_room/government_press_releases/press_release/article/slovenian_government_restarts_privatization_process_48146/)

<sup>37</sup>Ligji për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, neni 8 dhe neni 10: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11340>



Akademisë por nuk përcakton se cka ndodhë tutje me te dhe nëse i njeiti raport i dërgohet Kuvendit.

Kryesinë e Akademisë e përbëjnë Kryetari, Nënkryetari, Sekretari shkencor dhe sekretarët e seksioneve të Akademisë. Kryesia për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Akademisë. Kryesia e Akademisë zgjidhet për një periudhë katër (4) vjetecare me të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat tjetër.

Kryetari i Akademisë udhëheq me Akademinë si dhe udhëheq punën e Kuvendit dhe Kryesisë. Kryetari zgjidhet nga Kuvendi i Akademisë me mandat katër (4) vjetecar me të drejtë zgjedhjeje edhe për një (1) mandat tjetër dhe se për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Akademisë.

### Propozimi

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ndër të tjera, ka për mandat krijimin e politikave, zbatimin e legjislacionit për zhvillimin e arsimit, duke përfshirë arsimin e lartë dhe shkencën në Kosovë, e cila gjithashtu përkrah hulumtimin lidhur me zhvillimin social, ekonomik, dhe kulturor. Gjithashtu Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sporteve krijon politika kulturore dhe përkrah sektorin e artit në përgjithësi.

Marr parasysh mandatin, të drejtat dhe përgjegjësitë e Akademisë, e njëjta do duhej të bartej në kuadër të ekzekutivit respektivisht në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Vazhdimi i funksionimit të kësaj Akademie si institucion i pavarur e cila në bazë të ligjit në fuqi është në kuadër të Kuvendit por që e njëjta nuk i raporton për punën e vet Kuvendit kësaj krijon problematikë në mbikëqyrjen e saj rrejdhimisht e bënë më komplekse mënyrën e punës së saj.

Në këtë kontekst, rekomandohet të bëhet bartja e Akademisë përmes ndryshimeve përkatëse ligjore.

Për të bërë këto ndryshime, kërkohet të bëhen ndryshime ligjore.

## **V. Faza II - Grupimi i rregulltarovë sipas fushës nën një ombrellë**

Aktualisht në Kosovë janë më tepër se dhjetë (10) rregullatorë të themeluara.

Duke u nisur nga funksionet dhe shërbimet që ofrojnë rregullatorët në Kosovë, Kuvendi në koordinim me Qeverinë përmes ndryshimeve përkatëse ligjore do të mund të bënin grupimin e rregullatorëve sipas fushës nën një ombrellë.

Nga mënyra se si funksionojnë, mandati dhe përgjegjësitë e Rregullatorëve në Kosovë, propozimi është që të bëhet grupimi i tyre.

Në këtë fazë do të duhej të shikohej mundësia që si shembull:

Grupi 1: Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, Komisioni për Miniera dhe Minerale, Zyra e e Rregullatorit të Energjisë, Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit të grupohen nën një ombrellë.

Grupi 2: Po ashtu për sa i përket rregullatorëve që merren me çështje të sigurisë, grupimi do të mund të bëhej si në vijim: Autoriteti i Aviacionit Civil, Autoriteti i Hekurudhave të grupohen nën një ombrellë.

Grupi 3: Komisioni i Pavarur për Medie, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Bordi i RTK-së të grupohen në një vend. Për sa i përket RKT-së Ligji është në procesin e rishikimit dhe në këtë kontekst do duhej t'i bëhej një analizë e mirëfillët e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të Bordit të RKT-së për të mundësuar një funksionim të pavarur dhe të pandikuar nga politika.

Ky grupim i rregullatorëve sipas fushave do duhej të pasohej me një rishikim të kompetencave dhe shërbimeve që ofrojnë këta rregullatorë. Modernizimi i administratës publike i institucioneve publike është çështje me rëndësi e cila në vazhdimësi potencohet nga Bashkimi Evropian në raportet e saj. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve mundësohet vetëm atëherë kur të drejtat dhe përgjegjësitë e secilit institucion, janë mirë të precizuara në legjislacionin përkatës.

Në kontekst të rishikimit të kompetencave dhe përmirësimit të ofrimit të shërbimeve, duhet pasur parasysh që mundësohet ruajtja e buxhetit dhe ofrimi i shërbimeve në mënyrë më efektive me më pak shpenzime për bizneset dhe qytatarët.

## VI. Faza III - Ndryshimet Kushtetuese

Në kohën kur pritet të ndodhin ndryshime kushtetuese, qoftë për çështjet që kanë të bëjnë me aspektet e sigurisë apo ndryshimet në sistemin zgjedhor, Kuvendi do duhet të rishikoj mundësinë dhe të përgatisë amendamentet kushtetuese edhe për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencitë e Pavarura.

Kushtetua e Republikës së Kosovës, në disa raste në mënyrë taksative i specifikon Agjencitë/autoritetet për ushtrimin e kompetencave të caktuara. Si shembull mund të marrim nenin 130 të Kushtetutës i cili specifikon që Autoriteti Civil i Aviacionit të Republikës regullon veprimtarinë e aviacionit civil në Republikën e Kosovës dhe është ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror, sikur është përcaktuar me ligj.

Ngjashëm është rasti me Komisionin e Pavarur i Medieve përkatësisht neni 141.

*Cështja e parë (1): Specifikimi me emërtime i institucioneve në Kushtetutë, në përgjithësi ka krijuar një të kuptuar në shoqëri se kemi të bëjmë me mbivendosje të Agjencive të Pavarura . Kjo nuk është e saktë, pasi që secila Agjenci/autoritet i pavarur ka rëndësinë e njëjtë. Cështjet e funksionimit, strukturës, llogaridhënies, raportet e tyre me Kuvendin etj. duhet të precizohen mirë në një ligj të vecantë i cili vendos dispozita të qarta për kushtet e krijimit, strukturën e agjencisë, mënyrën e përzgjedhjes së pozitive udhëheqëse, mandatin e tyre, pavarësinë financiare etj.*

*Prandaj, në këtë kontekst, Kuvendi duhet të shikojë mundësinë që në Kushtetutë të përcaktoj veprimtarinë dhe çështjen që rregullohet, pa precizuar agjencinë apo autoritetin. Si shembull, veprimtaria e aviacionit civil do rregullohet me Kushtetutë, ndërsa Autoritetit i Aviacionit Civil të rregullohet mbi bazën e ligjit specifik.*

*Cështja e dytë (2): Në procesin e amendamenteve kushtetuese, të rishikohet nenin 142 i Kushtetutës i cili do të ofroj dispozitë më të qartë ligjore se mbi çfarë baze do të mund të themelohet një Agjenci/autoritet i Pavarur. Cështjet tjera të pavarësisë funksionale dhe buxhetore duhet të precizohen saktë në nenin 142 të Kushtetutës.*

## **VII. Rekomandimet e përgjithshme mbi ri-organizimin e Agjencive të Pavarura**

Problemet e identifikuara lidhur me numrin e lartë të Agjencive të Pavarura dhe vështirësitë të cilat i has Kuvendi në mbikëqyrjen parlamentare të këtyre Agjencive, janë të një natyre e cila kërkon jo vetëm vullnet politik, por gjithashtu kërkon kohë për zgjidhjen e tyre pasi që kërkojnë ndryshime ligjore për arritjen e synimeve në aspektin e racionalizimit të Agjencive.

Nga analiza e funksioneve të Agjencive/trupave të pavarura më sipër, mund të vërehet që të njëjtat ofrojnë funksione ekzekutive të cilat do duhej të ishin të vendosura në kuadër të ekzekutivit. Funksionet të cilat ofrohen, kryesisht mund të grupohen në katër (4) kategori:

1. Vendim-marrëse;
2. Inspektuese;
3. Trajnuese të ngritjes së kapaciteteve, dhe
4. Hulumtuese/shkencore.

Fokusi në këtë punim është që Agjencitë e Pavarura të identifikuara të cilat kryejnë funksione ekzekutive dhe që mandati i tyre lidhet me ndonjë resor në kuadër të ekzekutivit, të njëjtat të propozohen të barten në kuadër të ekzekutivit.

Sipas identifikimit të Agjencive të Pavarura të prezantuara në këtë punim, janë gjithësej shtatë (7) Agjenci të Pavarura të cilat janë themeluar nga Kuvendi i Kosovës sipas ligjeve specifike. Disa nga këto Agjenci kryejnë funksione klasike ekzekutive dhe disa kryejnë funksione rregullatore të cilat mund dhe do duhej të kryheshin në kuadër të ekzekutivit.

Faza e dytë (2) e prezantuar në këtë punim, ka të bëjë me një të ardhme afat-mesme ku pasi të jenë bartur shtatë (7) Agjencitë e propozuara nga Kuvendi në kuadër të ekzekutivit, më pastaj do të mund të bëhet një rishikim për Agjencitë/trupat tjerë ekzistues në kuadër të Kuvendit nëse duhet të vazhdojnë së ekzistuari, nëse po, të definohet në kuadër të Kuvendit apo Qeverisë duke definuar saktë të drejtat dhe përgjegjësitë e secilës Agjenci.

Rishikimi i Agjencive tjera do të mund të bëhet përmes analizës kost benefit, si dhe do duhej të bëhet një analizë e detajuar me qëllim shmangien e duplikimeve të kompetencave.

Në këtë drejtim, racionalizimi i Agjencive dhe rishikimi i kompetencave dhe shërbimeve që ofrojnë, vendosja e kornizës ligjore e cila në mënyrë të saktë precizon kompetencat dhe përgjegjësitë e secilit institucion, do të siguroj një administrim më të mirë të parësë publike, do të ndikoj pozitivisht në kursime buxhetore dhe njëkohësisht do të mundësoj ofrimin e shërbimeve më të mira për bizneset dhe qytetarët në përgjithësi.

Gjithashtu, duhet potencuar faktin, që Ligji për Qeverinë që nga viti 2009 është në procedurën e hartimit dhe ende i njëjti nuk është finalizuar dhe miratuar.

Kuvendi, do duhet t'i kërkojë Qeverisë sa më parë përgatitjen e Projektligjit për Qeverinë në përputhje me nenin 92 të Kushtetutës. Në rast, se nuk ndërmerren veprimet përkatëse nga ana e Qeverisë, Kuvendi mund ta ushtroj të drejtën e vetë të nismës legislative dhe të procedoj me hartimin e Ligjit për Qeverinë.

### **7.1. Rekomandimi specifik 1 (Opsioni i preferuar)**

Ka të bëjë me iniciimin e hartimit të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve përkatëse që rregullojnë funksionimin e shtatë (7) Agjencitë e Pavarura . Ky opsion nënkupton, që Kuvendi përmes një (1) ligji bënë ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve përkatëse.

Ky rekomandim do duhej të merrej në konsideratë nga ana e Kuvendit, pasi që sipas këtij rekomandimi, një Projektligj do të trajtonte çështjen e bartes së shtatë (7) Agjencive nga Kuvendi në Qeveri. Menaxhimi i këtij procesi do të ishte më i lehtë që të bëhej përmes një (1) ligji të vetëm.

Çështjet që do të ndryshoheshin dhe plotësoheshin përmes këtij Projektligji kanë të bëjnë me aspektet si vijon:

1. Bartja e Agjencisë në kuadër të ezekutivit përkatësisht ministrisë përkatëse varësisht nga fushëveprimi sikurse është prezantuar më sipër në këtë raport për secilën agjenci vecmas;
2. Përcaktimi i përgjegjësisë së qartë të agjencisë dhe raporti i saj me Ministrinë;
3. Definimi i mënyrës dhe procedurës së emërimit të pozitave të larta drejtuese dhe aspektet e mandatit, të përcaktohet pas mbarimit të mandateve ekzistuese, emërimi bëhet sipas legjislacionit përkatës të shërbimit civil;
4. Definimi i statusit të nëpunësve aktual të Agjencive të cilat do të barten nga Legjislativi në Ekzekutiv;
5. Definimi i llogaridhënies, mënyrës së raportimit në funksion të rishikimit të mandatit të agjencisë apo rregullatorit;
6. Vendosja e dispozitave përfundimtare dhe kalimtare prej një (1) viti pas hyrjes në fuqi të ligjit të përfundoj procesi bartjes së Agjencive nga Kuvendi në Qeveri përfshirë aspektet buxhetore dhe çështjeve tjera.
7. Vendosja e dispozitave përfundimtare dhe kalimtare me crast do të vendosej një afat kohor për ekzekutivin, që brenda tre (3) viteve pasi të miratohet ligji, Qeveria të bëjë një rishikim horizontal të Agjencive në kuadër të ekzekutivit përmes analizës kost-benefit për të siguruar se korniza ligjore dhe institucionet/Agjencitë në kuadër të ekzekutivit i kanë mirë të definuara përgjegjësitë dhe se ekziston nevoja për vazhdimin e funksionimit qoftë me modifikimet e nevojshme.

### **7.2. Rekomandimi specifik 2 (Opsioni i dytë)**

Hartimi i një (1) ligji të ri për krijimin dhe funksionimin e Agjencive e ekzekutive.<sup>38</sup>

Përmes këtij opsioni, Kuvendi do të miratoj një (1) ligj kornizë për Agjencitë ekzekutive ku do të përcaktoheshin rregulla të qarta për kriteret, fushat dhe funksionet për të cilat mund të krijohet një

---

<sup>38</sup> Rekomandimi për hartimin e një ligji të ri për Agjencitë e Pavarura është prezantuar në punimin që ka të bëjë me Rregullimin ligjor të Agjencive të Pavarura të përgatitur nga INDEP.

agjenci ekzekutive duke marrë parasysh parimin e ndarjes së pushteteve të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në po këtë ligj do të vendosej kriter që para propozimit të themelimit të një agjencie, fillimisht të bëhet një analizë e kost benefitit dhe gjithashtu krijimi Agjencive të reja të bëhet vetëm përmes ligjit dhe jo akteve nënligjore. Gjithashtu objekt i rregullimit do të ishte mënyra e shuarjes së agjencisë.

Pëmes këtij ligji do të përcaktohej statusi juridik i agjencisë, struktura, komitetet drejtuese si dhe përgjegjësitë e tyre (numri i anëtarëve të tyre), mënyra e zgjedhjes së pozitive të larta drejtuese dhe mandati, rekrutimi i stafit, funksionimi i buxhetit, mbikëqyrja, llogaridhënia dhe transparencia.

Në dispozitat përfundimtare dhe kalimtare të këtij ligji, do të propozohet shfuqizimi i neneve përkatëse për shtatë (7) Agjencitë e identifikuar të cilat do të barteshin nga legjislativi në ekzekutiv (*shih më sipër Agjencitë/trupat që propozohen të barten nga Kuvendi në Qeveri*).

### **7.3. Rekomandimi specifik 3 (Opsioni i tretë)**

Rishikimi i Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratë Shtetërore

Ligji Nr. 03/L-189 për Administratë Shtetërore si ligj bazik horizontal i cili rregullon aspektet e strukturës dhe funksionimit të administratës publike, të përcaktoj të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me organizimin e administratës shtetërore, përfshirë edhe Agjencitë e Pavarura të cilat i raportojnë Kuvendit.

Ndër aspektet tjera që duhet të rregulloj ky ligj për organet e larta të administratës shtetërore, duhet të përcaktoj kriteret të qarta për kushtet dhe kriteret për themelimin e Agjencitë e Pavarura në kuadër të legjislativit dhe krijimin e Agjencive në kuadër të ekzekutivit.

Çështjet që u përmendën në rekomandimin e dytë (2) më lartë (*sikurse statusi juridik, struktura, komitetet, mënyra e zgjedhjes dhe emërimeve, analiza kost-benefit para se një agjenci të propozohet të themelohet etj.*), do duhej të ishin pjesë e materies së ligjit për administratën shtetërore dhe në këtë kontekst, vetëm pasi të jenë definuar qartë kriteret, kushtet, struktura e administratës shtetërore (*organet e larta, organet qendrore të pavarura dhe ekzekutive*), në dispozitat përfundimtare dhe kalimtare të këtij ligji, të përcaktohej bartja e shtatë (7) Agjencive nga Kuvendi në Qeveri përkatësisht në ministrinë përkatëse.

Për më tepër, në këtë kontekst, do të preferohej që të vendosej një afat realist prej një (1) viti pas hyrjes në fuqi të ligjit, që të përfundoj procesi i bartjes së shtatë (7) Agjencive/trupave nga Kuvendi në Qeveri, për të siguruar që tranzicioni të ndodhë në mënyrë lehtë të menaxhueshme dhe të sigurohet se bartja e buxhetit dhe aspektet tjera të funksionimit janë marrë në konsideratë.

Meqenëse rekomandimi i parë (1) është opsioni më i preferuar për të realizuar bartjen e Agjencive/trupave nga Kuvendi në Qeveri, në këtë dokument është përgatitur një shembull se si do dukej përmbajtja e Projektligjit për bartjen e Agjencive, për të nxitur diskutime dhe dhënë orientim se si mund të realizohet procesi i bartjes.

## VIII. Shtojca 1 (shembull i përmbajtjes së ligjit)

**Shembulli se si do duhej të dukej Rekomandimi 1 – Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me bartjen e Agjencitë e Pavarura të legjislativit në ekzekutiv.**

Shembulli i prezantuar në shtojcën 1 të këtij punimi trajton tre (3) agjenci sa për të ilustruar strukturën dhe përmbajen e ligjit, ku i njëjti dokument mund të zgjerohet tutje me katër (4) Agjencitë tjera. Sigurisht, që përmbajtja e ligjit mund të parashikoj ndonjë dispozitë shtesë ligjore përgjatë procesit të hartimit dhe shqyrtimit të tij nga institucionet publike.

### **Ligj Nr. xx për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve përkatëse që rregullojnë funksionimin e shtatë (7) Agjencive të Pavarura <sup>39</sup>**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

1. Ky ligj ka për qëllim të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve si në vijim:

1.1. Ligji Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë

1.2. Ligji Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore;

1.3. Ligji Nr. 04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

#### **Neni 2**

#### **Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë**

*(Këtu duhet nënvizuar se kjo Akademi mund të vendoset në Ministrinë e Drejtësisë apo në kuadër të Këshillit Gjyqësor. Në këtë shembull, propozimi është të bartet në MD. E njëjta metodologji do të mund të përdorej për bartjen në KGJK)*

1. Neni 4 i ligjit bazik fshihet dhe riformulohet si vijon:

#### **Neni 4**

#### **Simbolet**

1. Akademia ka flamurin dhe stemën identifikuese, të cilat miratohen nga Ministri i Drejtësisë.
2. Përzgjedhja e flamurit dhe stemës së akademisë bëhet përmes konkursit publik, pas të cilit drejtori do t'i ofrojë tri propozime ministrit.

2. Neni 5 i ligjit bazik fshihet dhe riformulohet si vijon:

#### **Neni 5**

#### **Statusi i Akademisë**

Akademia është agjenci ekzekutive, e cila vepron në varësi të ministrisë.

---

<sup>39</sup> Ky është vetëm një draft fillestar sa për të nxitur diskutime mbi modalitetet se si mund të realizohet procesi i transferimit të agjencive/trupave nga Kuvendi në Qeveri. Ky draft, nuk është dokument zyrtar i përgatitur nga ndonjë institucion publik dhe si i tillë duhet kuptuar.

3. Pas nenit 5 të ligjit bazik shtohet një nen i ri, neni 5A dhe neni 5B si në vijim:

#### **Neni 5A**

##### **Selia**

Selia e Akademisë është në Prishtinë.

#### **Neni 5B**

##### **Buxheti i Akademisë**

Buxheti i Akademisë sigurohet nga Ministria, shërbimet e ofruara me pagesë dhe nga donacionet.

4. Nënparagrafi 1.7 i paragrafit 1 të nenit 10 të ligjit bazik fshihet.

5. Neni 10 paragrafi 3 fshihet dhe riformulohet si vijon:

3. Këshilli Drejtues i paraqet Ministrin raport për punën e Akademisë së paku një herë në vit dhe jo më vonë se data 21 mars e vitit pasues.

6. Neni 11 paragrafi 6 fshihet dhe riformulohet si vijon:

6. Mënyra e punës dhe vendimmarrjes e Këshillit Drejtues rregullohet me akt nënligjor të propozuar nga ministria dhe të miratuar në Qeveri.

7. Neni 15 i ligjit bazik fshihet dhe riformulohet si vijon:

#### **Neni 15**

##### **Përbërja e Këshillit Programor**

1. Këshilli programor përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve të shtetit dhe ekspertëve tjerë.
2. Drejtori i Akademisë është anëtarë ex officio.
3. Mandati i anëtarëve të Këshillit Programor është katër (4) vite me të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat, me përjashtim të drejtorit ekzekutiv i cili emërohet dhe ka mandatin e zyrtarit të lartë drejtues sipas Ligjit përkatës për shërbimin civil.
4. Funkcionimi, mënyra e punës dhe kompenzimi rregullohen me akt nënligjor të vecantë të nxjerrë nga Qeveria sipas propozimit të Ministrisë.
5. Neni 18 i ligjit bazik fshihet dhe riformulohet si vijon:

#### **Neni 18**

##### **Emërimi dhe shkarkimi i drejtorit**

Emërimi i dhe shkarkimi i Drejtorit bëhet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit për Shërbimin Civil.

6. Neni 23 paragrafi 1 dhe 2 fshihen dhe riformulohen si vijon:

1. Struktura dhe numri i nëpunësve në Akademi përcaktohet me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës e cila miratohet nga Ministri sipas propozimit të Akademisë, në përputhje me Ligjin përkatës për Administratë Shtetërore.

2. Dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil, zbatohen për nëpunësit civil të Akademisë.
7. Neni 26 i ligjit bazik fshihet.
8. Neni 27 i ligjit bazik fshihet.
9. Neni 28 i ligjit bazik fshihet.

### **Neni 3**

#### **Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore**

1. Pas nenit 2 shtohet një nen i ri 2A si vijon:

#### **Neni 2A**

##### **Statusi i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore**

Këshilli është organ i cili vepron në vartësi të Ministrisë së Kulturës, e Rinisë dhe Sporteve.

2. Pas nenit 2A shtohet një nen i ri 2B si vijon:

#### **Neni 2B**

##### **Selia**

Selia e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore është e vendosur në Prishtinë.

3. Pas nenit 2B shtohet një nen i ri 2C si vijon:

#### **Neni 2C**

##### **Simbolet**

1. Këshilli, ka flamurin dhe stemën identifikuese, të cilat miratohen nga Ministri i Drejtësisë.
2. Përzgjedhja e flamurit dhe stemës së akademisë bëhet përmes konkursit publik, pas të cilit drejtori do t'i ofrojë tri propozime ministrit.

4. Neni 4 paragrafi 4.8 dhe 4.9 fshihen dhe riformulohen si vijon:

#### **Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore**

4.8. Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore, është organ i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Kulturës, e Rinisë dhe Sporteve.

5. Pas paragrafit 4.8 të nenit 4 shtohen paragrafët e ri si vijon:

4.8.A Organet e Këshillit janë:

4.8.1. Bordi, i cili përbëhet nga shtatër (7) anëtarë me mandat tre (3) vjeçar i zgjedhur nga Qeveria sipas procedurave të përcaktuara me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria sipas propozimit të Ministrisë së Kulturës, e Rinisë dhe Sporteve. Mënyra e funksionimit të Bordit rregullohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria.



4.8.2. Sekretariati, i cili është organ mbështetës profesional i përbërë nga nëpunës civil sipas rregullores së brendshme për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës të miratuar nga Ministria sipas propozimit të Këshillit.

6. Neni 5 paragrafi 5.1. i ligjit bazik fshihet dhe riformulohet si vijon:

5.1. Buxheti i Këshillit sigurohet nga Ministria dhe ndonjë burimi tjetër vendor dhe ndërkombëtar qoftë ai donacion ose sponsorizim.

### **Neni 3**

Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës

1. Neni 1 i ligjit bazik fshihet dhe riformulohet si vijon:

#### **Neni 1**

##### **Qëllimi**

1. Ky ligj ka qëllim rregullimin e menaxhimit të komplekseve memoriale të shpallura me vendim të Kuvendit si Zona me interes të vecantë kombëtar dhe me karakter historik.
2. Neni 3 i ligjit bazik fshihet dhe riformulohet si vijon:

#### **Neni 3**

##### **Statusi i Agjencisë**

1. Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës është organ i cili vepron në kuadër të Ministrisë përkatëse të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
2. Nëpunësit e Agjencisë kanë statusin e nëpunësve civil.
3. Neni 5 i ligjit bazik fshihet dhe riformulohet si vijon:

#### **Neni 5**

##### **Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë**

1. Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë emërohet sipas legjislacionit në fuqi për emërimin e zyrtarëve të lartë drejtues i cili udhëheq me Agjencinë dhe është përgjegjës për administrimin, funksionimin dhe menaxhimin e Agjencisë.
2. Kryeshefi Ekzekutiv për punën e vet i përgjigjet Ministrit përkatëse të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
3. Kryeshefi është përgjegjës për:
  - 3.1. administrimin dhe menaxhimin e Agjencisë;
  - 3.2. organizimin dhe punësimin e personelit, nxjerrjen e udhëzimeve administrative dhe marrjen e vendimeve për çështjet që u përkasin funksioneve të Agjencisë;
  - 3.3. menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve që i janë besuar Agjencisë;
  - 3.4. menaxhimin e buxhetit të Agjencisë dhe për mënyrën e shpenzimit të tij;
  - 3.5. përfaqësimin e Agjencisë brenda dhe jashtë vendit;
4. Drejtori i Agjencisë ushtron edhe detyra tjera të përcaktuara me këtë ligj.
5. Neni 6, neni 7 dhe neni 8 i ligjit bazik fshihen.
6. Neni 9 i ligjit bazik fshihet dhe riformulohet si vijon:

**Neni 8**  
**Buxheti i Agjencisë**

Buxheti i Agjencisë sigurohet nga Ministria, nga donacionet sipas legjislacionit në fuqi.

1. Neni 10 i ligjit bazik fshihet.
2. Neni 11 i ligjit bazik fshihet dhe riformulohet si vijon:

**Neni 11**  
**Struktura Organizative e Agjencisë**

Struktura e Agjencisë përcaktohet me Rregulloren organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës e cila miratohet nga Ministri sipas propozimit të Akademisë në përputhje me ligjin përkatës për Administratë Shtetërore.

IX. Tabela me agjencitë/autoritet e propozuara për bartje.

<u>Agjencia/autoriteti i propozuar për t'u bartu në kuadër të ekzekutivit</u>	<u>Ministria përkatëse në të cilën bartet Agjencia</u>
<b>Akademia e Drejtësisë</b>	Ministria e Drejtësisë apo Këshilli Gjyqësor i Kosovës
<b>Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor</b>	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe gjithashtu të shqyrtohet mundësia që të bëhet shkrirja e Këshillit dhe Departamentit në 1 trupë/organ brenda ministrisë
<b>Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale</b>	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Për më tepër, e njëjta do mund të rishikohej që nga niveli i Agjencisë të shëndërrohet në Departament në kuadër të MMPH.
<b>Agjencia për Ndihmë Juridike Falas</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>Agjencia për Krahasim dhe Verifikim të Pronës</b>	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
<b>Agjencia Kosovare e Privatizimit</b>	Ministria e Zhvillimit Ekonomik apo në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për shkaqet e Ligjit për Investimet Strategjike dhe Ligjit për Investimet e Huaja
<b>Akademia e Arteve dhe Shkencave e Kosovës</b>	Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

---

*“Kjo analizë është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”.*